

REISSWOLF --- Partneri juaj I Sigurte per Mbrojtjen e te Dhenave Personale

Kompania REISSWOLF Albania është e vetmja kompani në Shqipëri që e kryen veprimtarinë e “Shkatërrimit të dokumenteve” dhe “Arkivimit fizik dhe dixhital” të tyre në përputhje me standartet Europiane të mbrojtjes së të dhënave të parashikuara në **Rregulloren Europiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (General Data Protection Regulation, GDPR)**.

GDPR (General Data Protection Regulation), Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave, përcakton rregulla të unifikuara për të gjitha vendet anëtare të BE-së, mbi përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të tyre. Një nga risitë e saj është fakti që *efektet ligjore të saj do të shtrihen edhe ndaj kontrolluesve dhe përpunuesve jashtë vendeve të Bashkimit Europian që përpunojnë të dhëna personale të shtetasve të BE-së.*

Me hyrjen në fuqi të saj, në datën 25 Maj 2018, të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe që përpunojnë të dhëna personale të shtetasve të BE-së, kanë detyrimin që të ndërmarrin të gjitha masat teknike dhe organizative të nevojshme lidhur me përpunimin e të dhënave personale, pasi ne te kundert do te perballen me sanksione shume te medha.

GDPR është e detyrueshme për tu zbatuar nga te gjithe *Institucionet/Ndermarrjet Private, Kompani Bankare, Institucione Financiare, Kompani Sigurimi, Kompani Tregtare etj* që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.

Në veprimtarinë tone aplikohet praktika gjermane e trajtimit konfidencial dhe të sigurtë të dokumentacionit ne te gjithe proceset e perpunimit,

- **Shkatërrimin Konfidencial**
- **Arkivimin Fizik**
- **Arkivimin Digital**

te marra keto se bashku ose si sherbime te pavarura nga njeratjetra

Gjithashtu REISSWOLF Albania **operon në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar** për mbrojtjen e të dhënave personale, **Ligjin nr.9887, date 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”** dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,

“Ne e vlerësojmë rëndësinë e ruajtjes së të dhënave personale që ju përpunoni gjatë aktivitetit tuaj!

Ne kemi ndërtuar një kulture privatësie dhe sigurie të cilën e reflektojmë në cdo shërbim që ofrojmë !

Shtyllat kryesore të kompanisë tonë janë Siguria dhe konfidencialiteti !

Shmangni sanksionet dhe mbroni reputacionin tuaj ! “

Në këtë kuadër kompania jonë ka ndërmarrë masat si vijon:

- Kompania respekton të gjitha të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, parimet dhe masat e sigurisë dhe konfidencialitetit të parashikuara në GDPR;
- Kompania ka emëruar një “Data Protection Officer” (DPO) ose ndryshe “ekspert për mbrojtjen e të dhënave personale”, që mbikeqyr çdo fazë të përpunimit të të dhënave (të gjitha proceset e arkivimit dhe shkatërrimit) në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë evropian;
- Çdo proces përpunimi (**shkatërrim ose arkivim**), rregjistrohet për qëllime sigurie dhe provueshmërie;

Shkatërrimi

- Shkatërrimi i dokumentacionit kryhet në mënyrë të sigurtë dhe të pakthyeshme;
- Ofrojmë garancitë me të mëdha sa i përket sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialitetit pasi kemi hartuar gjithë kuadrin rregullator të brendshëm në përputhje me Ligjin nr.9887, date 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhenave Personale” dhe aktet nenligjore në zbatim të tij dhe Rregulloren e re Europiane për Mbrojtjen e të Dhenave Personale (GDPR);
- Stafi, i çdo niveli, është trajnuar lidhur me praktikatat e mbrojtjes së të dhënave personale (referuar legjislacionit vendas dhe atij evropian);

Arkivimi Fizik dhe Digital

- Sistemi elektronik i menaxhimit të arkives është hartuar në përputhje me standartet me të larta evropiane të sigurisë së të dhënave duke ofruar akses të kufizuar, në kohe reale dhe të vazhdueshëm;
- Sistemi është projektuar nga Reisswolf Gjermani dhe ofron lehtësi funksionale për çdo përdorues;
- Sistemi ofron mundësinë e garantimit në kohe reale të informacionit arkivor duke garantuar në kohë reale edhe të drejtat e subjekteve të të dhënave personale (individët), në rastin konkret të drejtat për akses, korrigjim etj, të cilat janë garantuar nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky sistem ofron shpejteshi në aksesimin e dokumenteve;
- Gjithshtu sistemi ofron siguri për gjurmimin dhe regjistrimin e çdo veprimi me të dhënat dhe dokumentet arkivore duke evidentuar akseset (ditën dhe orën);
- Kompania disponon edhe certifikatat e sigurisë

- ISO 9001:2015
- ISO 27001:2013
- ISO 14001:2015
- Naid-Europe
- PRISM International

te cilat përbëjnë një kusht bazë për sigurinë e të dhënave sipas legjislacionit vendas dhe atij evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

Duke zgjedhur REISSWOLF Albania keni zgjedhur një partner të sigurtë !